

LATEX



PËRSHKRIM

Është një aditiv për përmirësimin e llaçeve me bazë çimentoje.

KARAKTERISTIKA

Lateksi është një polimer sintetik që përdoret për të përmirësuar llaçin dhe shtresat e betonit me bazë çimentoje.

- Si një shtresë lidhëse midis betonit ose llaçit të vjetër dhe të ri.
- Për përmirësimin e llaçit ose rifiniturave me bazë gëlqere dhe çimento.
- Rrit ngjithmërinë e llaçit dhe papërshkueshmërinë nga uji.
- Përdoret për llaçe hidroizoluese me bazë çimentoje, duke ofruar rezistencë ndaj presionit hidrostatik.
- Përdoret për të përmirësuar rezistencën e llaçeve në themele.
- Përmirëson ndjeshëm kapacitetin ngjithës të rifiniturave.
- Mbron sipërfaqet e betonit nga dehidratimi.
- Lateksi rrit ndjeshëm ngjithmërinë, rezistencën mekanike, elasticitetin dhe papërshkueshmërinë nga uji në produktet ndërtimore me bazë çimentoje.

UDHËZIME PËR PËRGATITJEN

Sipërfaqet mbi të cilat do të aplikohet produkti duhet të jenë të pastra nga pluhuri, yndyra, vajrat, mbetjet, bojërat, etj.

APLIKIMI I PRODUKTIT

Lateksi përzihet me ujë dhe raporti i përzierjes varet nga karakteristikat që dëshirojmë t'i japim llaçit dhe ngjitësve për pllaka. Raporti i përzierjes së lateksit me ujë nuk duhet të jetë më i ulët se 1:5. Nëse ky raport është më i vogël, nuk do të ketë asnjë përmirësim apo përforsim në vetitë e llaçeve dhe ngjitësve me bazë çimentoje. Për përgatitjen e betonit dhe llaçit tradicional, fillimisht duhet të hidhet lateksi dhe më pas çimentoja dhe rëra, për të shmangur formimin e granulave. Përdorimi i tij rrit ndjeshëm përpunueshmërinë e produktit dhe kohën e tharjes. Të gjitha llaçet me bazë çimentoje që përzihen me lateks karakterizohen nga një ngjithmëri e mirë dhe elasticitet më i lartë në krahasim me llaçet e tjera që nuk përzihen me lateks.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Likuid
Ngjyra:	Bardhe
Densiteti:	1,04 Kg/l
pH:	7
Përmbajtja e lëndëve të ngurta:	35%
Viskoziteti:	30 MPa.s

RUAJTJA

18 muaj pas datës së prodhimit, nëse ruhet në paketimin origjinal, të paparë, në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Duhet të mbrohet nga ekspozimi direkt ndaj diellit dhe ngricës.

KONSUMIMI

1-3 Kg / 25Kg

PAKETIMI

1Kg, 5Kg, 10Kg Kuti plastike

INFORMACION MBI SHËNDETIN DHE SIGURINË

Mbajeni jashtë arritjes së fëmijëve. Në rast kontakti me sytë ose gëlltitje, kërkoni këshillë mjekësore menjëherë dhe tregoni përmbajtjen e enës. Mos e hidhni produktin në kanalizime..

